



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 57/09

Prishtinë, më 22.07.2009, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Müfera Şinik dhe Armend Zemaj, Riza Smaka dhe Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani dhe Shkumbin Demaliaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Hashim Rexhepi Guvernator i BQK-së, Gani Gërguri zv. Guvernator i BQK-së, Nexhat Kryeziu zv.guvernator i BQK-së, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit –MEF, Teki Shala nga NDI , monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 1.07.2009**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008 I ftuar : Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2529/Do-1588 së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Përvetësimin e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtimi dhe Zhvillim;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009 I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa;**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 dt. 23.04.2009 për Fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsimi, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. dt. 1.07.2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 1.07.2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008

Kryesuesi, vlerësoi raportin mirë të përgatitur, i cili përmbush standardet teknike të raportimit dhe ofron një pasqyrë të përgjithshme për sistemin financiar në vend. Për më tepër për të sqaruar këtë raport, ia dha fjalën Guvernatorit të BQK-së.

Hashim Rexhepi, Guvernator i BQK-së, theksoi se Raporti i BQK-së është gjithëpërfshirës, të cilit i'u është bashkangjitur edhe raporti i auditorit të jashtëm. Viti 2008 ka qenë i veçantë për Kosovën edhe sa i përket zhvillimit ekonomik. Përkundër krizës globale ekonomike që kalojë edhe në sektorët real të ekonomisë, ekonomia e Kosovës kishte një performancë të mirë, një rritje ekonomike prej 5.4%. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve në sektorin privat dhe shpenzimeve më efektive të buxhetit të Kosovës. Ndërsa viti 2009 për shkak të krizës globale po rritje ekonomike pritet të jetë prej 3.4 - 3.8 % . Kjo rënie në krahasim me vitin e kaluar pritet për shkak të jostabilitetit të çmimeve, rritjes së energjisë dhe rënies së investimeve nga jashtë. Kosova ishte e varur prej një deficiti të lartë tregtar (rreth 43%) që ka ndikuar edhe deficitin e llogarisë rrjedhëse. Sa i përket sektorit fiskal, ka shënuar një përfomancë të mirë. Sektori financiar ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2007. Në kuadër të sektorit financiar dominon sektori bankar. Bankat private kanë kapital të mjaftueshëm për të menaxhuar me krizat. Në këtë drejtim është krijuar edhe Komiteti për stabilitetin financiar dhe për menaxhimin e krizave. Rritje ka shënuar edhe sektori i sigurimeve, ku kemi pasur edhe sigurime të vullnetare. Ndërsa efektet negative janë shkaktuar nga humbja e vlerës së aksioneve në Trust, për çka shpresojmë se këtë vit do të kemi ngritje të vlerës së tyre. Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Autoritet Mbikëqyrëse Financiare të Kroacisë, Turqisë dhe jemi në proces të nënshkrimit edhe me Shqipërinë. Jemi afër standardeve të Baselit. BQK-ja është e organizuar mirë, dhe e qeverisur në mënyrë efektive, për çka edhe tregon raporti i auditorit të jashtëm.

Riza Smaka, vlerësoi materialin përmbajtësor. Konsideroi të rëndësishme që BQK-ja të ushtrojë kompetencat që nuk i ka tani për tani, në mënyrë që të ushtrojë funksionet e saja kushtetuese si institucion publik dhe politik që është. Ndërsa vlerësoi problematike çështjen e rasteve të siguruar nga kompanitë e sigurimeve. Ekziston një deskrapancë e madhe në mes asaj që është normative dhe praktike, e që si rezultat pëson qytetari. Gjithashtu problematike është edhe çështja e realizimit të pensioneve individuale.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin mirë të përgatitur, të cilin e begaton edhe raporti i auditorit të pavarur. Konsideroi të rëndësishme eksperiencën e arritur të stafit të BQK-së nga trajnimet e bëra jashtë vendit. Po ashtu vlerësoi punësimin e një numri të konsiderueshëm të femrave në BQK. Pyeti pse nuk janë ruajtur rezervave të kapitalit të BQK-së, ashtu siç kërkohet me ligj? Vlerësoi sektorin bankar stabil, megjithatë theksoi se nuk jemi të kënaqur me strukturën e kredive (dominojnë kreditë për tregti, ndërsa për bujqësi vetëm 4,4%). Pyeti a do të themelohet ndonjë Bankë për Bujqësinë, e

cila do ti ndihmonte zhvillimit të bujqësisë. Po ashtu u interesua a do të themelohet Banka për Postën? Ndërsa sa i përket mjeteve të Trustit të cilat nuk kanë dal jashtë Kosovës prej shtatorit të viti 2008, pyeti se a do të vazhdojë edhe më tutje kjo politikë?

Haki Shatri, vlerësoi raportin e përgatitur konform standardeve që tashmë ka krijuar BQK-ja. Megjithatë theksoi se ka nevojë për disa sqarime. Për dallim për institucionet tjera, për Trustin nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme për rënien e vlerës së aksioneve. Më pas pyeti e ka menduar BQK-ja të realizojë të gjitha funksionet që i garantohen me ligj? Gjithashtu pyeti sa përqind të depozitave paraqesin kursimet e Postës dhe Telekomit të Kosovës?

Armend Zemaj, theksoi se raporti përkon me kompetencat kushtetuese që i ka Banka Qendrore. Pyeti sa po i mbron BQK-ja bankat komerciale dhe kompanitë e sigurimeve që janë me kapital vendor?

Safete Hadërgjonaj, gjithashtu vlerësoi raportin të hartuar mirë, i cili është i pasur me të dhëna dhe pasqyron sistemin financiar në vend. Duke pasur parasysh faktin se institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare financiare (Enti i Statistikave, Dep. Makroekonomik në MEF, BQK-ja apo FMN-ja dhe BB) dalin me shifra të ndryshme për treguesit makroekonomik në vend, pyeti qfarë i keni raportet me institucionet vendore, që me rastin e publikimit të shifrave, ato të prezantohen për afërsisht të njëjta. Duke pasur parash faktin se mjetet e trustit janë të deponuara në dy bankat komerciale në Kosovë me kapital të huaj, pyeti ku qëndron problemi që bankat me kapital vendor nuk i plotësojnë kushtet për deponimin e këtyre mjeteve? Duke pasur parasysh se institucionet mikrofinanciare përfaqësohen me 7,3% në totalin e sistemit financiar, pyeti sa BQK-ja arrin të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre?

Hashim Rexhepi - Guvernator i BQK-së, në përgjigjen e pyetjeve, theksoi se me përgjegjësi të plotë kemi arritur ti realizojmë objektivat e parapara me ligj. Ndërsa është nevojë e kohës që BQK-ja të ketë funksione shtesë. Në këtë drejtim kemi filluar aktivitetin dhe do të përgatisim një draft, i cili do të plotësojë zbrazëtirat që ka ligji. Ligji aktual nuk rregullon limitin e kredisë, prandaj edhe nuk kemi mundësi për dhënien e kreditivitetit. Gjithashtu është duke u punuar edhe në ligjin e ri për bankat komerciale. BQK-ja nuk mund të bëjë diferencime në mes bankave apo kompanive të sigurimit me kapital vendor dhe të huaj. Rolin i saj është në rritjen e konkurrencës në sektorin bankar, të cilin funksion e ka ushtruar dhe si rezultat ka ndikuar në rënien e normave të interesit. Po ashtu draftligji i ri për sigurimet do të jetë gati për miratim në Kuvend. Ndërsa sa i përket institucioneve mikrofinanciare që janë mjaftë prezent, është menduar që me ndryshimet e reja ligjore t'iu ndryshohet statusi i tyre nga OJQ-të dhe të kalojnë në organizata biznesore, kur dihet se ushtrojnë aktivitet përfitues dhe duhet t'iu nënshtrohen taksimit. Në këtë drejtim shfaqet nevoja për krijimin e legjislacionit të përgjithshëm në fushën financiare. Në pyetjen për krijimin e Bankës për Bujqësinë dhe Bankën e Postës, theksoi se BQK-ja është organ rregullator dhe nuk bënë themelimin e bankave të tyre. Megjithatë në fushën e bujqësisë, bankat komerciale ofrojnë kamata me kushte të volitshme, por mungojnë projektet konkrete. Sa i përket trustit, është bërë maksimumi asaj që parashihet me ligj. Guvernatori nuk mund të ndërmer asgjë nëse politikat e bordit janë në pajtim me ligjin.

Nexhat Kryeziu, në pyetjen për depozitat e Postës, theksoi totali i depozitave të Postës është 17%.

Gani Gërguri, sa i përket pyetjes për mbajtjen e 5% të kapitalit në rezervat e BQK-së, theksoi se arsyeja e mosmbajtjes së saj ka të bëjë me faktin se i kemi të deponuara paratë e Thesarit dhe mund të rregullohet kjo sipas nevojës. Çështja e bashkëpunimit me institucionet tjera vendore për të dal me statistika të njëjta rreth shifrave për treguesit makroekonomik, ekziston bashkëpunim, por në këtë drejtim problemi qëndron në mungesën e ligjit për raportimet e pasqyrave financiare.

Kryesuesi, për sqarim njoftoi se me kërkesën e komisionit, projektligji për raportimet financiare i është kthyer mbrapa Qeverisë për shkak se ka qenë shumë i mangët. U pajtua me konstatimet për nevojën e plotësimit të kornizës ligjore në fushën financiare. Përndryshe raporti ofron informacione të mira, të përgjithshme për sistemin financiar në vend dhe Komisioni do të rekomandojë që raporti të jetë objekt diskutimi në Kuvend.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008.
 - II. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në seancën plenare, me rastin e shqyrtimit të Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008, të ftohet Guvernatori i BQK-së, që të raportojë në Kuvend.
 - III. I propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të përshpejtojë procedurat e hartimit dhe dorëzimit në Kuvend, të projektligjeve të parapara në strategjinë legjislative të Qeverisë për vitin 2009, me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore në fushën financiare.
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2529/Do-1588 së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Përvetësimin e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtimi dhe Zhvillim**

Kryesuesi, theksoi se kemi të bëjmë me një marrëveshje që ka rezultuar pas anëtarësimit të Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar dhe Ndërkombëtar, e me këtë rast Kosova merr obligim kthimin e kredive që janë marrë më parë nga këto institucione.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të ratifikojë Marrëveshjen mbi Përvetësimin e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtimi dhe Zhvillim si dhe Memorandumi i Misionit të Thesarit të Bankës Botërore 23-25 qershor 2009.
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009**

Kryesuesi, theksoi se Komisionit parasegjithash i intereson sa a janë përfshirë në kornizat buxhetore të buxhetit të rishikuar, kërkesa e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë dhe kërkesa e Zyrës së Auditorit Gjeneral, të cilat paraprakisht kanë marrë mbështetjen nga Komisioni. Ndërsa më pas bëri vërejtje për përgatitjen teknike të materialit. Kërkoj sqarim për ndryshimet që janë bërë në pjesën tekstuale që kanë të bëjnë me paradhënien.

Agim Krasniqi, njoftoi se kërkesa e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë është përfshirë, ndërsa e Zyrës së Auditorit Gjeneral, e kemi përfshirë pjesën e shtesave për auditorët dhe jo për të gjithë stafin. Arsyeja e ndryshimit të pjesës tekstuale që ka të bëjë me paradhënien ka të bëjë me

faktin se, duke parë praktikën që organizatat buxhetore nuk kanë qarë kokën për shpenzimin buxhetit të tyre me kohë, me ndryshimet e bëra i kemi kufizuar ato, në dhënien e avanceve në muajt e fundit të vitit.

Riza Smaka, vlerësoi tekstin të përgatitur dobët, qoftë në aspektin gjuhësor apo edhe nga teknika juridike e hartimit. Kërkoj që paragrafi 2 i nenit 1, të plotësohet me një nënparagraf të ri 2.1 me të cilin caktohet koha dhe sanksionet për ata që nuk respektojnë paradhënien. Po ashtu theksoi nuk ka pasur nevojë që neni 2 të riformulohej kështu, kur dihet se në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji zëvendësohen dispozitat tjera.

Besa Gaxherri, theksoi se është e papranueshme të diskutohet kjo pikë e rendit të ditës në mungesë të Ministrisë dhe duke parë materialin që është përgatitur teknikisht shumë dobët.

Agim Krasniqi, theksoi se janë bërë dy ndryshime esenciale, si në pjesën e të hyrave dhe në pjesën e shpenzimeve. Kredia e dedikuar për KEK-ut nuk do të ndodhë këtë vit. Është kërkuar një llogari e veçantë për borqet që do ti ketë Kosova. Më pas shpjegoi ndryshimet në strukturën ndarjes së shpenzimeve ndërmjet organizatave buxhetore, të cilat janë pasqyruar në tabelat buxhetore. Më pas theksoi se Qeveria ka vendosur që të jetë pronare e fondit të dividendes së PTK-së dhe këto mjete janë përfshirë në buxhetin e rishikuar, e të cilat mjete nuk do ti shpenzohet këtë vit..

Müfera Şinik, theksoi se në buxhetin e Ministrisë së Arsimit është një pozicion për ndërtimin e shkollave, por në atë nuk figuron projekti renovimi i shkollës fillore “Motrat Qiriazit” në Prizren, edhe pse ky projekt është përfshirë me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2009.

Haki Shatri, pyeti sa mendon MEF-i se është ligjore marrja e dividendes së PTK-së pa ndonjë vendim të bordit të saj dhe futja e saj në kornizat e buxhetit. Më pas duke shpjeguar buxhetin, theksoi se është paraparë buxhet deficitar (duke përjashtuar mjetet e PTK), janë zvogëluar të hyrat në kufi (rreth 20 mil-€). Nga ajo që është prezantuar, shifet se buxheti po merr tipare shpenzuese. Struktura e shpenzimeve kapitale nuk tregon se do të kemi rritje ekonomike, sepse jetëgjatësia e këtyre projekteve është shumë e shkurtër. Është paraparë një projekt për rrugën Carralevë-Komeoran (500.000€), edhe pse projekti është përfunduar. Mjetet e ndara për Ministrinë e Arsimit 4.7 mil-€ të paarsyeshme. Sugjeroi që me rastin e shfrytëzimit të mjeteve të PTK-së, të respektohen procedurat ligjore dhe ato do të mund të shfrytëzoheshin vetëm për një projekt kapital gjigant (rasti i autostradës Prishtinë- Tiranë).

Agim Krasniqi, në përgjigjen e znj. Sinik, theksoi se tabelën për projektet kapitale, dy pozicione nuk janë përshkruar në nivel të projekteve. Është menduar se Ministria në bashkëpunim me kuvendet komunale të vendos për ndërtimin e shkollave, prandaj edhe është quajtur ashtu.

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë në parim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 dt. 23.04.2009 për Fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsimi, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente

Kryesuesi, kërkoj nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Arsimi, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të Ndryshme

Kryesuesi, njoftoi anëtarët e komisionit se me dt. 24.07.2009 (e premte) prej ores 10:00, në AUK do të jetë një takim me GTZ për të diskutuar rreth mënyrës së realizimit të projektit për ndihmën që do ti ofrohej komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI